



Datë: 30.04.2026

A.nr.2081/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2081/2025, të datës 29.12.2026, të parashtruar nga ankuesja F.G, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2081/2025, e datës 29.12.2025, e parashtruar nga ankuesja F.G.

II. Mbetet në fuqi Lista e datës 08.12.2025, e Komisionit të Pranimi të Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me vlerësimin e kandidatëve në procedurën e pranimi për pozitën Zyrtar Ligjor në Prokurorinë Themelore në Pejë.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, F.G (*tutje referuar ankuesja*), përmes postës më datë 22.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, e pranuar më datë 29.12.2025 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.2081/2025, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën *Zyrtar Ligjor* në Prokurorinë Themelore në Pejë, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas konkursit Nr.04/2025, të datës 10.11.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8107/2025, Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidateve e datës 08.12.2025; Kopjen e Konkursit, për pozitën e punës “Zyrtar Ligjor”; Listën e ngushtë të kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë procedurë rekrutimi; Vendimin për themelimin e Komisionit të vlerësimit së bashku me Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimi; Dëshminë për njoftimin e testit me shkrim; Formularët e vlerësimit të intervistës nga anëtarët e Komisionit; Dosjen e kandidatit/palës ankuese në Këshill; Dosjen e kandidates fituese.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses është **e pabazuar, sepse:**

I. Gjendja e fakteve

Nga shkresat e lëndës, rrjedhë se:

- Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, më datë 10.11.2025, ka shpallur Konkursin Nr.04/2025 për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në Prokurorinë Themelore në Pejë, me kohëzgjatje të emërimit një (1) vit, me mundësi vazhdimi, klasa profesional 2, një vend pune.

- Konkursi ka qenë më afat të aplikimit nga data 10.11.2025 deri më datë 16.11.2025, dhe së në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, ndërsa, në listë të ngushtë si kandidatë që kanë plotësuar kriteret e pozitës së shpallur janë përfshirë shtatëmbëdhjetë (17) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja.

-Më datë 08.12.2025, Komisioni i Pranimi ka publikuar listën përfundimtare të vlerësimit të kandidateve, ashtu që, sipas kësaj liste ankuesja është renditur si kandidate e dytë më pikë të arritura, gjegjësisht ankuesja ka akumuluar 70.3 pikë të përgjithshme, ndërsa, si kandidate më më shume pikë rezultojnë të jetë A.M më gjithsej 80.6 pikë.

II. Pretendimet e ankuesit

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se lista përfundimtare nuk ofron elemente të mjaftueshme për të verifikuar respektimin e kriterëve të vlerësimit dhe parimin e barazisë, me të cilin krijohet dyshim i arsyeshëm për korrektësinë dhe proporcionalitetin e procesit të vlerësimit në tërësi. Shton se mënyra e paraqitjes së rezultatit nuk mundëson verifikimin objektiv nëse është respektuar kufiri maksimal prej 100 pikëve, është zbatuar parimi i mesatares aritmetike dhe është reflektuar në mënyrë proporcionale pesha prej 30% e vlerësimit të jetëshkrimit. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën, të kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivlerësim, të ndryshoj aktin administrativ përmes rivlerësimit të intervistës dhe jetëshkrimit ose të shfuqizoj aktin administrativ, në rast se organi administrativ nuk arrinë të demonstroj se rezultati final është përlogaritur në përputhje me rregulloren përkatëse.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë, dhe si rrjedhojë, nisur nga ky përcaktim ligjor të punësuarit në administratën e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore, Këshilli ka kompetencë për të vendosur lidhur me çështjen ankimore, ndërsa, Këshilli Prokurorial i Kosovës me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion për periudhë të caktuar, gjegjësisht përmes Rregullores Nr.09/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial, ku sipas nenit 1, të rregullores është përcaktuar se: ...“Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil me kontratë për një periudhë të caktua”*

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e duke u bazuar në autorizimet sipas nenit 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit për pozitën Zyrtar Ligjor në Prokurorinë Themelore në Pejë dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kriteret të përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: - *Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik dhe - Një (1) vite përvojë pune profesionale.*

Ndërsa, në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore Kolegji ju referua Rregullores Nr.09/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial, me theks të veçantë:

- Neni 4 [Themelimi i marrëdhënies së punës për kohë të caktuar]1. *Marrëdhënia e punës në administratën e sistemit prokurorial mund të themelohet me kontratë 1.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 2. Kontrata e punës për një periudhë të caktuar lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se sa tre (3) vjet për kontratën sipas nënparagrafit 1.1 të këtij neni dhe jo më të gjatë se sa dy (2) vjet për kontratën sipas nënparagrafit 1.2. të këtij neni. 3. I punësuarit me kontratë, sipas këtij neni, nuk gëzon të drejtën për vazhdim të kontratës së përkohshme, që tejkalon afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. 4. I punësuarit me kontratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit sipas akteve nënligjore, të miratuara nga Këshilli.*

-Neni 5 [Themelimi i marrëdhënies së punës për realizimin e projektit të caktuar] 1. *Marrëdhënia e punës në sistemin prokurorial mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar për realizimin e një projekti të caktuar. 2. Projekti sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të aprovohet nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe të ketë mbulesë financiare në buxhet.3. Përshkrimi i projektit sipas*

paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën kohëzgjatjen e projektit, koston e detajuar, numrin e punëtorëve që do të angazhohen dhe pagesën e tyre.

-Neni 6 [Themelimi i marrëdhënies së punës për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme] 1. Marrëdhënia e punës në sistemin prokurorial mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme për rastet si në vijim: 1.1. pushimit mjekësor pa pagesë; 1.2. pushimit të lehonisë; 1.3. ndjekjes së ndonjë trajnimit apo programi profesional në emër të institucionit; 1.4. transferimit të përkohshëm në detyra të tjera brenda apo jashtë vendit; 1.5. pezullimit sipas neneve 69 dhe 70 të LZP-së, 1.6. në raste të tjera të mungesës së përkohshme nga puna të përcaktuara me LZP, apo 1.7. për shkak të vëllimit të punës në administratën e sistemit prokurorial. 2. Themelimi i marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme mund të bëhet vetëm kur stafi administrativ mungon për arsyt sipas paragrafit 1 të këtij neni, së paku tre (3) muaj. 3. Marrëdhënia e punës sipas paragrafit 1 të këtij neni lidhet për aq sa është e nevojshme apo derisa të kthehet në punë stafi administrativ që zëvendësohet, por jo më gjatë sesa për një periudhë prej dy (2) vjetësh.

-Neni 7 [Procedura e përzgjedhjes] 1. Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme duhet të arsyetohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i pozitës dhe të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së. 2. Kërkesa për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për një projekt të caktuar aprovet nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së. 3. Procedurat e përzgjedhjes për pozitën me kontratë për një periudhë të caktuar zhvillohen nga DBNJ-ja në sistemin prokurorial. 4. Themelimi i marrëdhënies së punës në administratën e sistemit prokurorial me kontratë për një periudhë të caktuar në rast të mungesës së përkohshme bëhet për kategorinë e stafit teknik-administrativ, profesional dhe të specialistit – ekspertit, por pa u kufizuar, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur publike dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në LZP. 5. Shpallja e procedurës së përzgjedhjes për pozitë bëhet nga BNJ-ja në SIMBNJ në faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim në administratën e sistemit prokurorial bëhet sipas afatit të përcaktuar në shpallje, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër sesa shtatë (7) ditë. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak, përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimin paraprak e bën BNJ-ja që zhvillon procedurën e përzgjedhjes, ndërsa vlerësimin profesional e bën Komisioni i Përzgjedhjes. 9. Në procedurën e verifikimit paraprak kandidatët nuk vlerësohen me pikë, ndërsa në vlerësimin profesional mund të vlerësohen deri në njëqind (100) pikë.

-Neni 10 [verifikimi paraprak] 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit, nëse kandidatët për përzgjedhje në shërbimin civil administratën e sistemit prokurorial plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga DBNJ-ja, më së largu pesë (5) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. DBNJ-ja publikon në SIMBNJ (kur e njëjta të jetë funksionale) dhe në uebfaqen e sistemit prokurorial listën e kandidatëve që i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta.

-Neni 11 [Vlerësimi profesional] 1. Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit dhe zhvillohet nga Komisioni i Përzgjedhjes me mbështetjen e DBNJ-së. 2. DBNJ-ja njofton kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 3. Në intervistë vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në shpalljen e konkursit. 4. Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i përzgjedhjes, i cili përgatit

grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. 5. Intervista përmban dhjetë (10) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti shtatë (7) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për 6. Në intervistë kandidati mund të marrë më së shumti njëqind (100) pikë, prej të cilave tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV). 7. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 7.1. deri në dhjetë (10) pikë për arsimimin; 7.2. deri në pesëmbëdhjetë (15) pikë për përvojën relevante në punë dhe 7.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet relevante. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe jetëshkrimin. -Neni 12 [Shpallja e rezultatit përfundimtar]1. Vlerësimi përfundimtar i intervistës dhe jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve.2. Pas përfundimit të intervistës dhe vlerësimit të jetëshkrimit, Komisioni i përzgjedhjes përgatit listën përfundimtare, të cilën e përcjellë te DBNJ-ja, në të cilën shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. 3. Lista publikohet në SIMBNJ, në uebfaqen e sistemit prokurorial dhe në mjete të tjera të përshtatshme për informim.4. Kandidati që merr më së shumti pikë, **por jo më pak sesa pragu prej shtatëdhjetë (70) pikësh, konsiderohet kandidat fitues.**

-Neni 13 [Komisioni i përzgjedhjes]1. Komisioni i përzgjedhjes për vlerësimin profesional të kandidateve për përzgjedhje themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së. 2. Komisioni i Përzgjedhjes ka tre (3) anëtarë në këtë përbërje: 2.1. dy (2) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar për fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) nëpunës profesional i specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi, apo një (1) nëpunës i DBNJ-së.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit me numër 2061/2025, të datës 20.11.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka qenë në përbërje nga: 1. B.M, Koordinator në ZMNV, kryesues; 2. B.G, Udhëheqës i Njesisë për Komunikim Publik në SKPK, anëtar, dhe K.R, Zyrtar Ligjor në PTH Ferizaj, anëtar, e që në vlerësim të Kolegjit, përbërja e Komisionit të Pranimit ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 13 të Rregullores Nr. 09/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial.

Duke qenë se procedura për pranim në shërbim civil për periudhë të caktuar përbëhet nga intervista me gojë dhe së pretendimet ankimore i referohen në tërësi kësaj faze të vlerësimit, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se si pyetje të parashtruara në intervistë me gojë kanë qenë: 1.Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës së Zyrtarit Ligjor, me pikë maksimale 0-7; 2.Motivimi që ju ka shtyrë për konkurrim në këtë pozitë?, me pikë maksimale 0-7; 3.Në cilat raste lirohet një person nga përgjegjësia penale kur kryen veprë penale në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori qoftë ushtarak apo civil?, me pikë maksimale 0-7; 4.Cilët janë dëshmitarët e privilegjuar?, me pikë maksimale 0-7; 5. Si caktohet kohëzgjatja e paraburgimit tek të miturit?, me pikë maksimale 0-7; 6. Cilat janë shkeljet e rënda disiplinore sipas ligjit të punës?, me pikë maksimale 0-7; 7. Cilat janë llojet e pushimeve?, me pikë maksimale 0-7; 8. Si do të reagonit nëse vëreni shkelje të disiplinës ose etikës nga kolegët? me pikë maksimale 0-7; 9. Përshkruani procesin e regjistrimit dhe shpërndarjes së lëndëve në prokurori?, me pikë maksimale 0-7; 10. Si duhet të veprojë një zyrtarë ligjor kur një qytetar kërkon qasje në një lëndë që është në procedure hetimore?, me pikë maksimale 0-7. Kurse nga shqyrtimi i formularëve të vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit të Pranimit lidhur me ankuesen dhe kandidaten fituese Kolegji verën këtë gjendje faktike:

- **Kryesuesi i Komisionit B.M**, ka vlerësuar ankuesen: në pyetjen me numër një (1), gjashtë (6) pikë, në pyetjen me numër dy (2), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër tre (3), tre (3) pikë, në pyetjen me numër katër (4), katër (4) pikë, në pyetjen me numër pesë (5), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), katër (4) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7) katër pikë (4); në pyetjen me numër tetë (8), pesë (5) pikë; në pyetjen me numër nëntë (9), pesë (5) pikë dhe në pyetjen me numër dhjetë (10), me katër pikë (4). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total shtatëdhjetë (70) pikë.

-**B.G, anëtar**, ka vlerësuar ankuesen: në pyetjen me numër një (1), pesë (5) pikë; në pyetjen me numër dy (2), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër tre (3), dy (2) pikë, në pyetjen me numër katër (4), katër (4) pikë, pyetjen me numër pesë (5), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), tre (3) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7), katër dy (2) pikë; pyetjen me numër tetë (8), pesë (5) pikë; pyetjen me numër nëntë (9), tre (3) pikë dhe pyetjen me numër dhjetë (10), katër pikë (4). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total gjashtëdhjetë e katër (64) pikë.

-**K.R, anëtar**, ka vlerësuar ankuesen: në pyetjen me numër një (1), shtatë (7) pikë; në pyetjen me numër dy (2), pesë (5) pikë; në pyetjen me numër tre (3), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër katër (4), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër pesë (5) katër (4) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), pesë (5) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër tetë (8), katër (4) pikë; pyetjen me numër nëntë (9), shtatë (7) pikë dhe pyetjen me numër dhjetë (10) me katër pikë (4). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total shtatëdhjetë e shtatë (77) pikë.

-**B.M, Kryesuesi i Komisionit ka vlerësuar kandidaten fituese**: në pyetjen me numër një (1), gjashtë (6) pikë, në pyetjen me numër dy (2), gjashtë (6) pikë, pyetjen me numër tre (3), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër katër (4), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër pesë (5), gjashtë (6) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7) gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër tetë (8), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër nëntë (9), gjashtë (6) pikë dhe në pyetjen me numër dhjetë (10), katër gjashtë (6). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total tetëdhjetë e tre (83) pikë.

-**B.G, anëtar, ka vlerësuar kandidaten fituese**: në pyetjen me numër një (1), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër dy (2), pesë (5) pikë; në pyetjen me numër tre (3), gjashtë (6) pikë, në pyetjen me numër katër (4), gjashtë (6) pikë, pyetjen me numër pesë (5), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7), pesë (5) pikë; pyetjen me numër tetë (8), gjashtë

(6) pikë; pyetjen me numër nëntë (9), gjashtë (6) pikë dhe pyetjen me numër dhjetë (10), pesë pikë (5). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total tetëdhjetë e një (81) pikë.

-K.R, anëtar, ka vlerësuar kandidaten fituese: në pyetjen me numër një (1), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër dy (2), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër tre (3), katër (4) pikë, në pyetjen me numër katër (4), pesë (5) pikë, në pyetjen me numër pesë (5) pesë (5) pikë, në pyetjen me numër gjashtë (6), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër shtatë (7), gjashtë (6) pikë; në pyetjen me numër tetë (8), pesë (5) pikë; pyetjen me numër nëntë (9) e ka vlerësuar me gjashtë (6) pikë dhe pyetjen me numër dhjetë (10) e ka vlerësuar me katër pikë (4). Ndërsa, lidhur me jetëshkrimin (CV)-Arsimimi nga dhjetë (10) pikët maksimale, është vlerësuar me dhjetë (10) pikë, jetëshkrimin (CV)-Përvoja nga pesëmbëdhjetë (15) pikët maksimale është vlerësuar me pesëmbëdhjetë (15) pikë, jetëshkrimin (CV)-Trajnimet nga pesë (5) pikë maksimale është vlerësuar me zero (0), në total shtatëdhjetë e tetë (78) pikë.

Nisur nga gjendja fakteve si më sipër rrjedhë fakti se pyetjet kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe se pyetjet kanë qenë të parashtruara lidhur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në shpalljen e konkursit, Rrjedhimisht, ankuesja është vlerësuar me gjithsej 70.3 pikë nga 100 pikët maksimale, ndërsa, kandidatja fituese është vlerësuar me gjithsej 80.6 pikë të përgjithshme nga 100 pikët maksimale, andaj, mbi këto rrethana, Kolegji nuk ka arritur të evidentoj të meta në kuptim të vlerësimit të ankueses apo vlerësim jo të drejtë apo jo të barabartë lidhur me jetëshkrimin, sepse, shpërndarja e pikëve të vlerësimit tek dhjetë pyetjet dhe tek pjesa e jetëshkrimit ka qenë në pajtim me nenin 12 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.09/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial, është respektuar kufiri prej 100% sepse 70 % e pikëve janë ndarë për 10 pyetje, ndërsa 30% e pikëve të vlerësimit janë përcaktuar për jetëshkrim. Rrjedhimisht, vlerësimi lidhur me përgjigjet e dhëna në pyetje të parashtruara nga anëtarët e Komisionit të Pranimit është vlerësim diskrecional, ndërsa vlerësimi i Jetëshkrimit është vlerësim që bazohet në dokumentacionin material që kandidatët kanë dorëzuar me rastin e aplikimit.

Në fakt, nga analizimi i formularëve të vlerësimit, rrjedhë se ankuesja lidhur me arsimin dhe përvojën punës është vlerësuar me pikë maksimale, pra 10 pikë tek arsimi dhe 10 pikë të përvoja e punës, në total 20 pikë, kurse, lidhur me trajnimet është vlerësuar me 0 pikë, sepse, ankuesja nuk posedon ndonjë dëshmi lidhur me trajnime të ndjekura, po ashtu, vlerësimi i njëjtë është bërë edhe në raport me kandidaten fitues, pasi që kjo e fundit po ashtu nuk posedon dëshmi për ndjekje të ndonjë trajnimi.

Përkitazi me pretendimin ankimor nëse është zbatuar saktë parimi i mesataresh aritmetike sipas nenit 12 të Rregullores Nr.09/2024, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të paqëndrueshëm, ngase sipas formularëve të vlerësimit individual të anëtarëve të Komisionit të Pranimit, Kolegji ka vërtetuar se ankuesja nga kryesuesi i Komisionit është vlerësuar në total 70 pikë, nga anëtari i dytë është vlerësuar me 64 pikë, dhe nga anëtari i tretë me 77 pikë, gjithsej $211(70+64+77=211\div 4=70.33)$.

Për me tepër, në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore, Kolegji ka analizuar edhe dosjen e kandidatës së shpallur fituese në këtë procedurë të pranimit, nga dhe ka gjetur së e njëjta posedon Diplomën nr.544, të datës 24.10.2017, për përfundimin e studimeve themelore më datë 05.09.2017, në Fakultetin Juridik, Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën Gj.A.nr.213/2025, të datës 30.05.2025, të lëshuar nga Administratori i Gjykatës Themelori në Pejë, më të cilin është vërtetuar së A.M ka kryer praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë në kohëzgjatje prej një viti gjegjësisht nga data 03.06.2024 deri më 30.05.2026, dhe si rrjedhojë kandidatja e shpallur fituese ka plotësuar kriteret për pozitën e shpallur.

Nisura nga rrethanat dhe konstatimet si më sipër, dhe duke qenë së nuk janë evidentuar shkelje ligjore të cilat do të cenonin ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, Kolegji erdhi në përfundimin së procedura e pranimit lidhur me pozitën Zyrtar Ligjor në Prokurorinë Themelore në Pejë, është zhvilluar në pajtim me dispozitat materiale, kështu që, duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2081/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.G;
- Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.